




Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	01.12.2015
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP 03-03/2612/15
PËR/ZA/TO:	z. Sadri KASTRATI Koordinator i Prokurimit në nivel të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës
CC:	z. Curr GJOCAJ Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me Filma dhe Pajisje përcjellëse "

I nderuari z. Kastrati,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin " Furnizim me Filma dhe Pajisje përcjellëse " me numër prokurimi 701-15-088-111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizim me Filma dhe Pajisje përcjellëse " me numër prokurimi 701-15-088-111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Arsy etimi

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, duke pasur parasysh nevojën esenciale dhe imediate për furnizimin e Klinikave dhe shërbimeve përkatëse njësisive organizative të QKUK/SHSKUK-së me filma dhe pajisje përcjellëse të domosdoshëm, ka iniciuar procedurën e prokurimit publik me titull "**Furnizim me Filma dhe pajisje përcjellëse**" me numër prokurimi: 701-15-088-111, ku ka paraparë procedurën e hapur të tenderimit me vlerë të madhe të kontratës.

Autoriteti Kontraktues Shërbimi Spitalor, klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK) me datë 30.08.2015 ka paraqitur kërkesë zyrtare në Agjencinë kundër Korrupsionit, përmes së cilës ka kërkuar që AKK të jet pjesë e vëzhgimit lidhur me ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderit me titull "**Furnizim me Filma dhe pajisje përcjellëse**" me numër prokurimi: 701-15-088-111. Agjencia kundër Korrupsionit ka marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit në lidhje me procesin e vlerësimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ku ka konstatuar faktet si më poshtë:

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka ekzaminuar dokumentet përbërëse të këtij tenderi dhe ka analizuar me kujdes procesin e vlerësimit të tenderëve ka konstatuar se për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 18 Operator ekonomik, ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 5 prej tyre.

Çmimet e ofruara nga Operatorët ekonomik të lexuara në hapjen e tenderëve dhe pas korrigjimeve aritmetikore që ka pas tek një Operator ekonomik kanë qenë si në vijim:

Operatori ekonomik Konti ka ofertuar me çmim prej 576,401.15 €, pas korrigjimeve aritmetikore çmimi është 636,401.15 €, Pegasuss 589,900.00 €, Medica 548,750.00 €, Kosova Med 623,301.15 €, Ledi Med 640,850.00 €.

Vlerësimi i tenderëve nga Komisioni vlerësues

Komisioni për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve (*Komisioni i parë*), pas vlerësimit të ofertave të Operatorëve Ekonomik, ka konstatuar 2 prej Operatorëve ekonomik nuk i kanë plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes (kualifikimit) që janë caktuar në Dosjen e këtij tenderi, andaj Komisioni vlerësues i ka shpallur si të pa përgjegjshëm. Ndërsa 3 Operator ekonomik i kanë plotësuar kriteret e kualifikimit konform dosjes së tenderit, mirëpo tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme, Komisioni vlerësues, pasi ka analizuar me kujdes ofertat e 3 Operatorëve ekonomik më konkretisht, katalogjet që kanë ofruar këta Operator, ka vërejtur se jo të gjitha pozicionet e specifikimeve teknike i plotësojnë e në disa raste nuk i ka gjetur specifikimet teknike në katalogje për këta tenderues. Komisioni vlerësues për shkak të paqartësive në lidhje me atë se a'i plotësojnë këta Operator ekonomik, specifikat teknike të kërkuara, u ka dërguar edhe pyetje shtesë Operatorëve konkurrues në mënyrë që t'i sqarojnë ato pozicione të Specifikimeve teknike, tek të cilat Komisioni vlerësues ka pasur paqartësi dhe që nuk ka arritur t'i gjej në katalogjet e tyre.

Komisioni vlerësues, ka pranuar përgjigjet, prej këtyre Operatorëve ekonomik, të cilët në sqarimet e tyre kanë theksuar se i plotësojnë specifikat e kërkuara duke i bashkangjitur edhe deklaratat e prodhuesve, ku kanë deklaruar se i plotësojnë specifikimet teknike. Për më tepër në sqarimet e tyre, ata i'u janë referuar edhe katalogjeve dhe kanë sqaruar se në cilat faqe të katalogjeve mund të gjinden pozicionet e specifikimeve teknike. Komisioni vlerësues edhe pasi ka pranuar sqarimet dhe përgjigjet nga këta Operator ekonomik nuk është bindur se i plotësojnë të gjitha pozicionet e specifikimet teknike të detyrueshme.

Pozicionet e Specifikimeve teknike që nuk janë plotësuar, sipas Komisionit vlerësues janë si në vijim: **Operatori ekonomik Ledi –med**, sipas komisionit vlerësues nuk i ka printerët laserik ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit, pastaj nuk e plotëson pozicionin nr.4 tek Mamography shpejtësia e plateve në orë ku është kërkuar minimum 40, ky ka ofruar shpejtësinë 38 nën minimumin e kërkuar. Në pyetjen e dytë që i ka drejtuar Komisioni vlerësues i njëjti nuk është përgjigjur rreth këtij pozicioni. **Operatori ekonomik Medica** sipas komisionit vlerësues nuk e ka plotësuar pozicionin nr.2 ku është kërkuar shpejtësia e pllakave në orë për radiography *të jetë minimum 70*, i njëjti sipas Komisionit vlerësues nuk e plotëson këtë kërkesë pasi që në formatin *radiography plate 35x43 e ka shpejtësinë 69 e jo 70 siç është kërkuar*. Ky Operator ekonomik sipas Komisionit vlerësues nuk e plotëson dhe nuk e ka të definuar *në katalog edhe pozicionin nr.3 ku është kërkuar që shpejtësia e plateve në orë për Mamography të jet 40*. **Operatori ekonomik Kosova Med**, sipas Komisionit vlerësues ky Operator ekonomik nuk e ka plotësuar vetëm pozicionin *nr.4 ku është kërkuar monitori digjitalizues të jet minimum 21 inch*, sipas Komisionit vlerësues nuk e ka të specifikuar në katalog madhësinë e monitorit.

Meqenëse, Komisioni vlerësues nuk është dakorduar mes veti rreth përmbushjes se këtyre pozicioneve nga Operatorët konkurrues, atëherë kanë vendosur që të votojnë secili prej tyre ku me ç'rast kemi 3 vota për anulim e këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa 2 nga anëtarët e Komisionit vlerësues kanë votuar që të vazhdohet tutje drejtë dhënies së kontratës. Zyrtari Kryesor i Prokurimit i SHSKUK-së, pasi ka pranuar rekomandimin e Komisionit vlerësues ka vendosur që të bëjë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Autoriteti kontraktues me dt.02.10.2015, ka publikuar, përmes faqes elektronike të KRPP-së njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme.

Kundër njoftimit për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit ka pasur ankesa nga dy Operator ekonomik. Në raportin e ekspertit teknik të datës 28.10.2015 theksohet se asnjëri nga Operatorët ekonomik ankues nuk i kanë plotësuar specifikimet teknike të detyrueshme të dosjes së tenderit. Për më tepër eksperti teknik i është referuar edhe një interpretimit të Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik të datës 15.09.2015 të cilën e ka kërkuar Autoriteti kontraktues. Në këtë interpretim theksohet decidivisht se “ **Specifikimet teknike janë kërkesa të obligueshme të cilat të gjithë tenderët duhet të respektojnë në mënyrë që të jenë të përgjegjshëm duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 8 i udhëzuesit operativ për prokurimin publik, andaj nëse një Operator ekonomik nuk i plotëson specifikimet teknike nuk mund të trajtohet si Operator ekonomik i përgjegjshëm** “. “Bazuar në nenin 59 paragrafi 4 thuhet se “Autoriteti

kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit “.

Bazuar në konstatimet e ekspertit teknik si më lartë, eksperti i ka rekomanduar Panelit të OSHP-së, që t'i refuzojë si të pabazuara ankesat e Operatorëve ekonomik ankues, ndërsa të aprovoj vendimin e autoritetit kontraktues Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të datës 01.10.2015.

Zyrtari Kryesor i Prokurimit, gjatë seancës dëgjimore në OSHP, pasi ka paraqitur vlerësimin e Komisionit dhe vendimin e tij në lidhje me këtë aktivitet “ ka kërkuar nga Paneli i OSHP-së ndihmë meqenëse, ky aktivitet sipas tij ka filluar që 1 vit e gjysmë dhe gjithashtu sipas tij ky aktivitet i prokurimit është me interes të përgjithshëm dhe konform nenit 133 ruajtja e interesit publik i ka propozuar Panelit që të mos e anuloj këtë aktivitet të prokurimit dhe çfarëdo vendimi tjetër do të ishte me interes për pacientët, pasi që kemi mungesë dhe jemi totalisht të boshatisur sa i përket këtij artikulli “.

Komisioni i ri-vlerësimit të tenderëve

Me datë 10.11.2015 Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka nxjerrë vendim me të cilin i ka aprovuar si pjesërisht të bazuara ankesat e 2 Operatorëve ekonomik ankues për këtë tender, me ç'rast ka urdhëruar Autoritetin kontraktues që lëndën ta kthej në ri-vlerësim në mënyrë që Autoriteti kontraktues t'i vërtetojë edhe njëherë se Operatorët ekonomik ankues se a'i plotësojnë kërkesat minimale të Autoritetit kontraktues të kërkuara në dosjen e tenderit, *lidhur me madhësinë e monitorit, shpejtësinë e pllakave si dhe çështjen e printerëve të ofertueseve të ndryshëm.*

Komisioni ri- vlerësues pasi ka bërë ri- vlerësimin e të dy ofertave të Operatorëve ankues ka konstatuar se vetëm njëri nga Operatorët ekonomik i plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikimet teknike minimale të dosjes së tenderit, andaj ka rekomanduar që me Operatorin e vetëm ekonomik i cili sipas Komisionit ri-vlerësues është i përgjegjshëm të lidhet kontrata. Zyrtari Kryesor i prokurimit i SHSKUK-së, pasi ka pranuar rekomandimin e Komisionit ri-vlerësues ka aprovuar të njëjtin duke e nënshkruar raportin e ri-vlerësimit të tenderëve, për Operatorin e vetëm ekonomik i cili sipas këtij komisionit ka dorëzuar tender të përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Raportin e ri-vlerësimit të tenderëve e kanë nënshkruar të gjithë anëtarët e Komisionit ri-vlerësues dhe Zyrtari Kryesor i Prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka ekzaminuar dhe analizuar me kujdes dokumentacionin në dispozicion lidhur me këtë procedurë të prokurimit, dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e këtij tenderi dhe ka analizuar me kujdes edhe dokumentet e procesit ri-vlerësues, konsideron se asnjëri prej këtyre Operatorëve ekonomik ankues nuk i plotëson në tërësi specifikimet teknike të detyrueshme të dosjes së tenderit për arsyet e cekura si më lartë. Komisioni ri-vlerësues pa i vërtetuar edhe njëherë ka konstatuar se kemi vetëm një ofertë të përgjegjshme, ani pse ky Operator ekonomik nuk e ka pasur të definuar në katalog madhësinë e ekranit për monitor.

Duke u bazuar në raportin e Komisionit ri-vlerësues, komisioni ri-vlerësues ka rekomanduar që kontrata t'i ipet këtij Operatori ekonomik të vetëm i cili sipas tij është i përgjegjshëm. Raporti i procesit ri-vlerësues është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe nga Zyrtari Kryesor i Prokurimit.

Shkeljet sipas AKK-së

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se një veprim i tillë nga ana e Autoritetit Kontraktues bie ndesh me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nenin 32 Rregullat e Përgjithshme paragrafin 4 dhe 5. Sipas këtij neni theksohet në mënyrë decisive se nëse, gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit. Pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni kur më pak se dy tender të përgjegjshëm apo kërkesa për pjesëmarrje janë dorëzuar në përgjigje të një procedure të hapur, procedure të kufizuar apo procedure të negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë, me kusht që *a)* specifikimet e para të kontratës nuk ndryshohen *b)* që autoriteti kontraktues ka demonstruar që për arsye të konkurrencës shumë të kufizuar në treg për kontratën në fjalë, një procedurë e re e hapur, e kufizuar ose e negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë nuk do të rezultoi në ngritje të numrit të tenderëve përgjegjës, kur është e aplikueshme, kërkesat për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues mund të anulojë këtë kërkesë. Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik, duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues përkatës brenda dy ditëve nga dita e vendimit për anulimin e kërkesës. Mirëpo pavarësisht se LPP lejon revokimin e kërkesës me më pak se dy tender të përgjegjshëm, megjithatë në rastin konkret Autoriteti Kontraktues nuk ka demonstruar se ekziston një konkurrencë shumë e kufizuar për këtë lloj furnizimi dhe fakti se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit ka pasur prej 16 deri në 18 Operator ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen për këtë tender dhe kanë ofertuar 5 prej tyre, tregon shumë qartë se ka numër të mjaftueshëm të Operatorëve ekonomik të interesuar që bëjnë furnizimet e tilla. Gjithashtu fakti që ky aktivitet i prokurimit është në proces për më tepër se 1 vit nuk mund të nënkuptohet vetëm për shkak të konkurrencës shumë të kufizuar, por kjo mund të ndërlidhet edhe me formulimin e paqartë dhe kufizues të specifikimeve teknike që janë kërkuar në dosjen e këtij tenderi.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se me rastin kur Komisioni ri-vlerësues e ka konsideruar si të përgjegjshëm njërin Operator, ani pse ky Operator ekonomik nuk e ka pasur të definuar në katalog madhësinë e monitorit dhe e ka eliminuar tjetrin për shkak se nuk i ka përmbushë të gjitha pozicionet e specifikimeve teknike ka bërë trajtim jo të barabartë duke përdorur standarde të dyfishta në kundërshtim të plotë me rregullat e vlerësimit të tenderëve. Sipas Komisionit ri-vlerësues **Operatori ekonomik Medica** nuk e ka plotësuar pozicionin nr.2 ku është kërkuar shpejtësia e pllakave në orë për radiography *të jetë minimum 70*, i njëjti edhe sipas Komisionit ri-vlerësues nuk e plotëson këtë kërkesë pasi që në formatin *radiography plate 35x43 e ka shpejtësinë 69 e jo 70 siç është kërkuar*. Ky Operator ekonomik sipas Komisionit ri- vlerësues nuk e plotëson dhe nuk e ka të definuar *në katalog edhe pozicionin nr.3 ku është kërkuar që*

shpejtësia e plateve në orë për Mamography të jet 40. Në letrën standarde rreth eliminimit të këtij Operatori ekonomik, Autoriteti kontraktues, ndër të tjera si arsye e ka cekur edhe faktin se monitori i ofruar i prodhuesit Helwet Packard nuk ka autorizim nga prodhuesi dhe certifikatat e kërkuara në dosjen e tenderit. Agjencia kundër Korrupsionit vëren se në katalogun e ofruar nga ky Operator ekonomik për digjitalizuesin (kompjuterin) janë ofruar këto specifitime teknike si në vijim :

Classic CR i prodhuesit amerikan carestream me këto specifika teknike

Classic CR	18x24 cm	24x30 cm	35x35 cm	35x43 cm	15x30 cm	35x84 cm
	77	58	77	69	92	68

Agjencia vëren se Operatori tjetër i cili sipas Komisionit ri-vlerësues është i përgjegjshëm ka ofruar digjitalizuesin e prodhuesit FUJIFILM ku në formatin më të vogël të plateve 18x24 cm fillon nga 73 plate për orë. Lidhur me këtë Operator ekonomik, Komisioni vlerësues dhe ri-vlerësues e ka vlerësues shpejtësinë e plateve vetëm në këtë format, pa i verifikuar edhe në madhësitë tjera. Në katalogun e këtij prodhuesi është e definuar shpejtësia e plateve për madhësinë e plateve 18x24 cm, ndërsa në madhësitë tjera është e paqartë. Komisioni i ri-vlerësimit të tenderëve ka qenë i detyruar që në bazë të vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit të datës 10.11.2015 të verifikojë madhësinë e monitorit, shpejtësinë e pllakave si dhe çështjen e printerëve të ndryshëm. Sipas dokumentacionit që posedon AKK, Komisioni i ri-vlerësimit të tenderëve nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në mënyrë që t'i verifikojë edhe njëherë këto çështje.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se meqenëse, Komisioni i ri-vlerësimit dhe Zyrtari kryesor i prokurimit kanë konstatuar se ka vetëm një ofertë të përgjegjshme duhet të bëjnë anulimin e procedurës së prokurimit në mungesë të dy ofertave të përgjegjshme.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike, nenin 32 Rregullat e Përgjithshme dhe nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikatat e të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !